

Shërbimi
Seancë Plenare

KUVENDI
NR 3748 DATE 07.11.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2025

Lënda: Depozitim projektligji.

Drejtuar: Z. Niko PELESHI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar z. Kryetar,

Bazuar në nenin 78, 81 pika 1, 83 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 68, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”.

Ju faleminderit.

DEPUTETI PROPOZUES

 RAMON KURTI






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2025

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.58/2022 “PËR KRIJIMIN,
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PARQEVE TEKNOLOGJIKE DHE
SHKENCORE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim deputeti,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore” të bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Ne nenin 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në gërmën (dh) në fund të paragrafit shtohet fjalia “ *Përdoruesi rezident i parkut regjistrohet në territorin e parkut me NIPT/NUIS parësor ose/dhe me NIPT/NUIS dytësor në territore të ndryshme nga territori i parkut. Përfshirë, Start-up, Punonjësit Dixhital Lëvizës dhe Istitucionet e Arsimit të Lartë trajtohen mutatis mutandi si përdorues rezident apo të përfshirë në park sipas rregullave dhe kushteve të parashikuara posaçërisht për këto kategori në një Vendim të Këshillit të Ministrave*”

2. Pas gërmes (ë) shtohen gërmat (j), (k), dhe (m) me këtë përmbajtje:

“j) “*Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve të një përdoruesi të parkut*” është marrëveshja e lidhur ndërmjet një institucioni/enti/autoriteti publik/zhvilluesi kur është ent publik dhe përdoruesit të parkut, nëpërmjet së cilës përdoruesi i parkut me initiative apo me kërkesë nga enti/autoriteti/institucioni publik/zhvilluesi, shet aksione apo krijon një shoqëri të përbashkët/sipërmarrje të përbashkët, sipas kushteve dhe kriterëve të bazuara në një

marrëveshje tip të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe të negociuara nga palët.

k) “Marrëveshja e bashkëpunimit për një produkt /shërbim inovativ” është akti i lidhur midis një institucioni/enti/autoriteti publik dhe një përdoruesi që ka aksioner një ent publik apo zhvilluesin, akt i cili bazohet në modelin tip të kontratës të miratuar me vendim të Këshillit të ministrave, që përcakton ndër të tjera rregullat e bashkëpunimit, “cmimin preferencial” dhe kohën së përdorimit të produktit/krijimit/shërbimit/mallit të krijuar në park.

m) “Datacenter” është infrastruktura fizike, teknologjike sëbashku me sistemet mbështetëse në funksion të magazinimit, përpunimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së të dhënave elektronike në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurt.”

Neni 2

Në nenin 4 pika 3 shtohet fjalia : Përrjashtimisht, veprimtaria e parkut virtual/në distancë fillon me lidhjen e marrëveshjes midis zhvilluesit dhe institucionit përgjegjës.”

Neni 3

Ne nenin 5 bëhen këto ndryshime dhe shtesa: .

1. Në pikën 1 në fund të fjalisë hiqet togëfjalëshi “apo të shërbimeve”
2. Në pikën 2 pas gërmës (ç) shtohet gërma (d) me këtë përmbajtje: “(d) Krijojnë dhe mirëmbajnë infrastruktura digjitale për shërbime/produkte digjitale apo datacentërs”
3. Pas pikas 3 shtohet pika 4 me kete përmbajtje:

“4. Veprimtaritë e lejuara në park mund të zhvillohen në mënyrë virtuale/në distancë, në mënyrë fizike apo hibride sipas marrëveshjes së zhvillimit të miratuar nga institucioni përgjegjës si dhe tur parashikuar në aktin e shpalljes së parkut. “

Neni 4

Ne nenin 8 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3 fjalia e parë zëvendësohet si vijon:” Zhvilluesi mund të lidhë kontratë administrimi të parkut me persona të tjerë fizikë ose juridikë, të huaj ose vendës”
2. Në pikën 5 në fund të paragrafit shtohet fjalia:

“Institucioni i arsimit të lartë mund të ushtojë veprimtaritë e lejuara në park në cilësinë e përdoruesit resident në bazë të një marrëveshjeje të veçantë të lidhur me zhvilluesin sipas kushteve, kriteve dhe rregullave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Ne nenin 10 pas gërmës (a) shtohen gërmat (b), (c) dhe (ç) me kete përmbajtje:

“(b) njihen në mënyrë prioritare me mallrat/shërbimet/krijimet e realizuara në park nga ana e përdoruesve, nëpërmjet katalogut të përditësuar të publikuar/ofruar nga zhvilluesi periodikisht.

(c) përfitojnë, në mënyrë preferenciale, mallrat/shërbimet/krijimet/produktet e realizuara në park nga një përdorues që ka aksioner mbi 51% një ent publik apo një shoqëri të përbashkët / sipërmarrje të përbashkët me nje ent publik kundrejt një cmimi preferencial që parashikohet në “Marrëveshjen e bashkëpunimit për një produkt inovativ” bazuar në kontratën e modelit tip të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.

(ç) lidhin marrëveshje bashkëpunimi për një produkt inovativ me përdoruesit të cilët kanë aksioner një apo më shumë ente publike përfshirë edhe zhvilluesin, lidhur me mallrat/shërbimet/produktet inovative/krijimet e tyre në park.

Neni 6

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime :

1.1 Përmbajtja e gërmës (d) ndryshon si vijon :“(d) Aplikohet shkalla 0 (zero) përqind e TVSH-së për :

(i) mallrat, pajisjet dhe shërbimet e përdorura në park, të cilat shërbejnë për nxjerrjen e “produktit inovativ” si dhe tarifa e aplikuar nga zhvilluesi/menaxhuesi tek përdoruesi.

(ii) produktet, shërbimet dhe zgjidhjet inovative të krijuara në park, nga përdoruesit me aksionar entin publik mbi 51%, të cilat përdoren nga institucionet, entet dhe autoritetet publike për ushtrimin e funksioneve publike dhe që nuk hyjnë në qarkullim tregtar,. Në këto raste, produkti inovativ trajtohet si mall apo shërbim i prodhuar për nevoja shtetërore dhe nuk konsiderohet furnizim i tatueshëm sipas legjislacionit në fuqi për TVSH-në.

(iii) produktet, shërbimet dhe zgjidhjet inovative të krijuara në park të cilat përdoren nga subjekte jashtë parkut për të cilat legjislacioni i fushës aplikon shkallën 0 të TVSH apo përjashtim të saj.”

1.2 Pas gërmës (e) shtohet gërma (e1) me këtë përmbajtje : “e/1) Ofrojnë/shesin/shkëmbejnë aksione me një ent publik në këmbim të një transakcioni financiar apo në natyrë sipas kushteve dhe termave të negociuara në marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve të një përdoruesi të parkut”;

2. Pas pikas 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Shoqëritë e përbashkëta të krijuara ndërmjet një përdoruesi dhe një enti publik si edhe përdoruesit të cilët kanë aksioner një ent/autoritet publik, pavarësisht kuotes së aksioneve, bashkëpunojnë me institucionet/entet/autoritetet publike në kushtet e marrëveshjes së bashkëpunimit për një produkt/shërbim inovativ, bazuar në marrëveshjen tip të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, dhe në bazë të negociimit përkatës të autorizuar nga organet vendimarrëse sipas legjislacionit të zbatueshëm.

Neni 7

Në nenin 15 ndryshohet me këtë përmbajtje :

“ Neni 15

Pronësia intelektuale dhe të drejta të tjera

1. Përdoruesit në park duhet të regjistrojnë pronësinë intelektuale për krijimet e zhvilluara në park edhe me autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

2. Zhvilluesi ndihmon përdoruesit me regjistrimin e krijimeve në Republikën e Shqipërisë dhe në përdorimin e tyre nga institucionet/entet publike sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit për një produkt inovativ të negociuara mes përdoruesit, zhvilluesit dhe institucionit/entit publik përfitues.

3. Zhvilluesi mund të përfitojë një pjesë të të ardhurave që gjenerohen nga pronësia intelektuale, nga transakcionet e lidhura me ofrimin e shërbimit / produktit/ mallit për institucionet/entet publike, për krijimet/mallrat/shërbimet që zhvillohen në zonë nga përdoruesit për një periudhë 5-vjeçare, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e lidhur ndërmjet zhvilluesit /institucionit/entit publik dhe përdoruesit.

4. Të dhënat e përdurura për qëllim të krijimit të produkteve inovative nëse janë pronë e institucioneve publike, në bazë të marrëveshjes me zhvilluesit e parkut mund të përdoren nga përdoruesit që kanë aksioner një ent/institucion/autoritet publik me kusht që produkti të përdoret ekskluzivisht prej një institucioni/enti/autoriteti publik apo një enti tjetër të autorizuar/miraturar prej tij apo në zbatim të një marrëveshje ndërqeveritare. Në përdorimin e të dhënave përdoruesi zbaton parashikimet e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

5. Aksesi në bazat e të dhënave shtetërore jepet për zhvilluesin nëse është ent publik sipas rregullave të legjislacionit sektorial. “

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

NIKO PELESHI

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.58/2022 “PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PARQEVE TEKNOLOGJIKE DHE SHKENCORE”

QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ndryshimet e propozuara me këtë iniciativë ligjore synojnë:

1. Përmirësimin e kuadrit ligjor për funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore si hapësirë që kanë potencialin për të stimuluar investimet në ndërmarrjet e bazuara në teknologji, rritjen e proaktivitetit të enteve publike për një qasje më efektive ndaj zhvillimit të aktivitetit inovativ, produkteve inovative me fokus integrimin e sistemit kombëtar të inovacionit në hapësirën e kërkimit dhe inovacionit të BE-së.
2. Plotësimin e angazhimit mbi zhvillimin e politikave publike, politikave fiskale dhe qasjes integrale ndaj ekosistemit të inovacionit dhe sipërmarrjes publike të angazhuar në parqet teknologjike dhe shkencore nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës ligjore, duke parashikuar dispozita të reja normuese për zgjerimin e rrethit të përdoruesve të parkut, duke përfshirë në definimin e përdoruesit rezident të parkut *start-up-e* punonjësit digjitalë lëvizës dhe institucionet e arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtaritë e lejuara në park dhe parashikimin e lehtësive rregullatore dhe fiskale për institucionet, entet dhe autoritetet publike të përfshira në veprimtaritë e lejuara në park nëpërmjet shoqërive të përbashkëta të krijuara ndërmjet një përdoruesi dhe një entit publik ose përdoruesit të cilët kanë aksioner një ent/autoritet publik.

VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave. Projektligji nuk është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve miratuar për vitin 2025.

ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Qëllimi kryesor i projektligjit është plotësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore si pararojë të inovacionit, duke nxitur përfshirjen, me statusin e përdoruesit rezident, në këto hapësira ku integrohen struktura kërkimore e zhvillimore të cilat përdorin teknologji të avancuar në zhvillimin e produkteve ose shërbimeve inovative, të institucioneve të arsimit të lartë, *start-up*-eve dhe punonjësve digjitalë lëvizës si dhe rregullime të veçanta për përdoruesit rezidentë të parkut.

Përparësitë dhe efektiviteti i këtij projektligji konsistojnë në nxitjen dhe mbështetjen e qasjes proaktive të institucioneve, enteve dhe autoriteteteve publike në angazhimin e përdoruesit të parkut dhe ndaj produktit inovativ nëpërmjet marrëveshjeve të angazhimit të përbashkët apo marrëveshjeve të bashkëpunimit që parashikohen specifikisht në projektligj dhe dhënien e incentivave konkretë në lehtësitë fiskale dhe rregullatore për këto autoritete publike.

Një tjetër risi e projektligjit është plotësimi i vakuumit ligjor në lidhje me përfshirjen nga zhvilluesi i parkut të një institucioni të arsimit të lartë, vendës ose të huaj, të akredituar sipas legjislacionit përkatës të vendit të origjinës. Projektligji si një instrument parësor konkretizon rolin e institucionit të arsimit të lartë që mund të ushtrojë veprimtarimtë e lejuara në park në cilësinë e përdoruesit rezident në bazë të një marrëveshjeje të veçantë të lidhur me zhvilluesin, sipas kushteve, kriterëve dhe rregullave të përzgjedhjes/angazhimit, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 5 nene, të cilat janë të strukturuar si më poshtë:

Në nenin 1 parashikohet ndryshimi i nenit 3, “përkufizimet”, të ligjit në fuqi në kuadër të përfshirjes në definimin e termave që i referohen përdoruesit rezident të parkut, “datacenter”, “Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve të një përdoruesi të parkut” dhe Marrëveshja e bashkëpunimit për një produkt inovativ.

Në nenin 2, në nenin 3 dhe nenin 4 të projektligjit parashikohen një ndryshim dhe shtesa në nenin 4, 5 8 të ligjit në fuqi, në kuadër të plotësimit të dispozitës me rregullimin mbi përfshirjen nga zhvilluesi i parkut të një institucioni të arsimit të lartë, vendës ose të huaj. Kjo dispozitë përcakton se institucioni i arsimit të lartë mund të ushtrojë veprimtaritë e lejuara në park në cilësinë e përdoruesit rezident në bazë të një marrëveshjeje të veçantë të lidhur me zhvilluesin, sipas kushteve, kriterëve dhe rregullave të përzgjedhjes/angazhimit, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, duke përfituar të gjitha lehtësitë fiskale sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 12, të ligjit në fuqi.

Në nenin 5, të projektligjit parashikohen disa shtesa në nenin 10, të ligjit në fuqi, me qëllim dhëniën e disa lehtësive rregullatore që i atribuohen vetëm institucioneve, enteve dhe autoritetet publike që kanë të drejtë:

- të njihen në mënyrë prioritare me mallrat/shërbimet/krijimet e realizuara në park nga ana e përdoruesve, nëpërmjet katalogut të përditësuar të publikuar/ofruar nga zhvilluesi periodikisht.
- të përfitojnë, në mënyrë preferenciale, mallrat/shërbimet/krijimet/produktet e realizuara në park nga një përdorues që ka aksioner një ent publik apo një shoqëri të përbashkët me nje ent-publik kundrejt një cmimi preferencial që parashikohet në “Marrëveshjen e bashkëpunimit për një produkt inovativ”
- lidhin marrëveshje bashkëpunimi për një produkt inovativ me përdoruesit të cilët kanë aksioner një apo më shumë ente publike përfshirë edhe zhvilluesin, lidhur me mallrat/shërbimet/produktet inovative/krijimet e tyre në park.

Neni 6 parashikon ndryshimin e pikave 1 dhe setimin e pikës 5, të nenit 12, të ligjit në fuqi duke përcaktuar se Shoqërite e përbashkëta të krijuara ndërmjet një përdoruesi dhe një enti publik si dhe përdoruesit të cilët kanë aksioner një ent/autoritet publik, pavarësisht kuotës së aksioneve, të entit publik, bashkëpunojnë me institucionet/entet/autoritetet publike në kushtet e bashkëpunimit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës.

Neni 7 parashikon zgjerimin e objektit të rregullimit të nenit 15, të ligjit në fuqi duke parashikuar krahas pronësisë intelektuale dhe të drejta të tjera. Ndryshimi parashikon se zhvilluesi ndihmon përdoruesit me regjistrimin e krijimeve në Republikën e Shqipërisë dhe në përdorimin e tyre nga institucionet/entet publike sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit për një produkt inovativ të negociuara mes përdoruesit, zhvilluesit dhe institucionit/entit publik përfitues.

Gjithashtu kjo dispozitë garanton se të dhënat e përdurura për qëllim të krijimit të produkteve inovative nëse janë pronë e institucioneve publike, në bazë të marrëveshjes me zhvilluesit e parkut mund të përdoren nga përdoruesit që kanë aksioner një ent/institucion/autoritet publik me kusht që produkti të përdoret ekskluzivisht prej një institucioni/enti/autoriteti publik apo një enti tjetër të autorizuar/miratuar prej tij apo në zbatim të një marrëveshje ndërqeveritare. Në përdorimin e të dhënave përdoruesi zbaton parashikimet e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Aksesi në bazat e të dhënave shtetërore jepet për zhvilluesin nëse është ent publik sipas rregullave të legjislacionit sektorial.

RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare të këtij projektligji . Ska

PROPOZUESI

DEPUTETI
